



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A

**Shkoder me 18.10.2023**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Furnizim elektropompa zhytесе per stacionet e pompimit te ujerave te zeza dhe furnizimit me uje

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Pompa uji

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

10.803.333 (Dhjetë milion e teteqind e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UK Shkoder ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar. specifikimet teknike janë hartuar nga Dega Teknike, me përmbajtjen si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Specifikime teknike
----	----------	---------------------

1	F.V Elektro-pompe zhytесе per ujra te zeza, KSB Tip-KRTD 80-315/552 UG-S	<p>(Q= 223,01m<sup>3</sup>/h H=45 m, P=55 Kw, n= 2950 rrot/min) U=400V 3~ 50hz, Nr. Pole-2 Te dhena teknike:-Helika e pompes “tipi D” –Helike diagonale me nje kanal, e apur. (Per ujra te ndotura me material te ngurta e fibra te gjata e qe permbajne ajer ose gaz).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Diametri nominal i helikes -242 mm.</li> <li>-Diametri ne dergim i pompes -80 mm.</li> <li>-Diametri i jashtem i pompes max 420 mm.</li> <li>-Temperatura max e lengut 55 °C.</li> <li>-Thellesia e instalimit max. 10 m.</li> <li>-Materiali trupit pompes Gize.</li> <li>-Materiali I helikes-Gize.</li> <li>-Montimi ne pus te lagesht, lidhja e pompes me shkarkimin eshte lidhje automatike me tel udhezues ose me dy shufra udhezuese.</li> <li>-Numri I poleve - 2.</li> <li>-Nisja e motorit me Yll/ trekendesh.</li> <li>-Kablli i energjise motorike me 7 berthama te rënda me dy berthama kontrolli të ekranizuar me çifte të përdredhur. Niveli i izolimit të përcjellësit prej 90°C, i cili lejon rritjen e rrymës. Rezistencë e lartë mekanike dhe rezistente ndaj gërryerjes dhe grisjes. Rezistent ndaj kimikateve brenda pH 3-10 dhe rezistent ndaj ozonit, vajit dhe flakës. Përdoret deri në temperaturën e ujit deri në 70°C. Kabllot &lt; 7G6 mm<sup>2</sup> me berthama kontrolli të pambrojtura.</li> <li>-Permasat gabarite jo me te medha se 56x46x110 cm (Gjatesia flanaxhes bashkuese deri ne fund te diametrit me te madh X Diametri me i madh i trupit pompes X Lartesia elektropompes)</li> </ul>
2	F.V Panel elektrik komandimi e mbrojtjeje Yll/trekendesh-55kw Per Elektro-pompe zhytесе per ujra te zeza, KSB Tip-KRTD 80-315/552 UG-S	<p>(Q= 223,01m<sup>3</sup>/h H=45 m, P=55 Kw, n= 2950 rrot/min, U=400V 3~ 50hz, Nr. Pole-2.)</p>

3	<p>F . V. - Elektro-pompë zhytëse për ujra të zeza, FLYGT Tip-N3153 HT, 181-1510659 450 /289 mm</p>	<p>(P=13.5 Kw, Q=120 m<sup>3</sup>/h H=24 m,n= 1455 rrot/min) U=400V 3~ 50hz, Nr. Pole-2 Te dhena teknike: -Pompa me helike vetepastruese. -Diametri ne dergim i pompes -100 mm. -Temperatura max e lengut 40 °C. -Thellesia e instalimit max. 10 m. -Materiali trupit pompes Gize. -Materiali I helikes-Gize. -Montimi ne pus te lagesht,lidhja e pompes me shkarkimin eshte lidhje automatike me tel udhezues ose me dy shufra udhëzuese. -Kablli elektrik i motorrit me nivel izolimit të përcjellësit prej 90°C, i cili lejon rritjen e rrymës. Rezistencë e lartë mekanike dhe rezistente ndaj gërryerjes dhe grisjes. Rezistent ndaj kimikateve brenda pH 3-10 dhe rezistent ndaj ozonit, vajit dhe flakës. Përdoret deri në temperaturën e ujit deri në 70°C. Permasat gabarite jo me te medha se 56x44x85 cm</p>
4	<p>F.V - Elektro-pompe zhytëse per ujra te zeza, AMAREX:N D-100-220/04 4 UL G-220</p>	<p>(Q=129,6 m<sup>3</sup>/h H=6,39 m, P=3,7 Kw, n= 1360 rrot/min) U=415V 3~ 50hz, Nr. Pole-4 -Helika e pompes “tipi D” –Helike e hapur diagonale me nje flete. (Per ujra te ndotura me material tengurta e fibra te gjata e që përmbajnë ajër ose gaz). -Diametri nominal i helikes -220 mm. -Diametri ne dergim i pompes -100 mm. -Temperatura max e lengut 55 °C. -Thellesia e instalimit me e vogel se 10 m. -Materiali i trupit pompes -Gize. -Materiali i helikes - Gize. -Montimi ne pus te lagesht, lidhja e pompes me shkarkimin eshte lidhje automatike me tel udhezues ose me dy shufra udhëzuese. -Temperature për lëngun deri në 55 ° C). -Numri I poleve -4.</p>

5	F - Elektro-pompe zhytuese ujit te pishem	<p>Q= 240-420 m<sup>3</sup>/h, H=30-20 m, P=37 Kw, U=400V 3~ 50hz, Nr.Poleve-2, Lidhja e elektromotorit y/Δ- me 2 kablllo me gjatesi 30 m)-</p> <p>-Diametri ne dergim i pompes –200-300 mm.-</p> <p>Diametri me i madh I trupit te pompes – 295 mm</p> <p>-Temperatura max e lengut 35 °C.</p> <p>-Perqendrimi i grimcave te ngurta (reres) - 50 gram/m<sup>3</sup></p> <p>-Thellesia e instalimit me e vogel se 20 m.</p> <p>Materiali pompes çelik e gize</p>
---	---	--

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimi

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2019,2020 dhe 2021, me nje vlere jo me te ulet se 40% e fondit limit te ketij prokurimi. **Kjo Kërkese konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Vlera e kerkuara jane ne perputhje me percaketimin e nenin 43/2 te VKM nr. 285 dhe tregon kapacitetin financiar te operatoreve ekonomik ofertues, duke vertetuar qendrushmerine dhe eksperiencen e operatoreve.

---

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e vertetimit te xhiros vjetore eshte bere bazuar ne nenin 43/1 te VKM 285, ku eshte lene mundesi entit prokurues qe te kerkoj vertetim mbi xhiron deri ne tre vitet e fundit te operatoreve ekonomik

2.1.2 Pasqyrat financiare per vitet ( 2020,2021,2022) te konfirmuara nga administrata tatimore, *ku te paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Percaktimi i ketij kriteri argumentohet si më poshtë:

Ky kriter eshte gjykuar si i domosdoshem per te percaketuar ecurine financiare te operatoreve ekonomik, pasi tregon raportin ndermejt aktiveve dhe pasiveve dhe eshte ne perputhe me percaketimin e nenin 43/4 te VKM nr. 285

---

## 2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 40% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e

mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vertetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses

---

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat objekt prokurimi, kjo e vertetuar nepermejt dokumentave original ose te noterizuara si perfaqesues I kompanise prodhuuese per te gjitha mallrat objekt prokurimi. Ne rast paraqitje te autorizimit nga distributori, OE duhet te paraqese dokumentacionin per te vertetuar se subjekti ne fjale eshte distributor zyrtar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi ka të bëjë me informacione e nevojshme për autoritetin kontraktor në lidhje me prodhuesin e produkteve dhe mundësinë reale për të bërë furnizimin, nepermejt autorizimit që i jepet operatorit ekonomik ofertues.

2.2.3 Operoret ekonomik ofertues duhet të kenë mesatarisht jo më pak se 5 punonjës të siguruar për periudhën 3 muajt (Korrik, Gusht, Shtator 2023), të vertetuar nga administrata tatimore, si dhe listë –pagesat përkatëse.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40 pika 5/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi pjesa më e madhe e disa zera janë furnizim dhe vendosje, për të cilat kërkohet dhe kërkohet fuqi punëtore për realizimin e kontratës.

2.2.4 Operoret ekonomik ofertues duhet të kenë të punësuar një inxhinier elektrik, i cili është në listë –pagesat përkatëse. Për inxhinier elektrik duhet të paraqitet edhe licenca e tij profesionale.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë

perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40 pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi kemi te bejme me furnizime dhe instalime te karakterit elektrik, te cilat nuk mund te kryehen pa nje drejtues ing. elektrik

2.2.5 Ofertuesit ekonomik ofertues duhet te paraqesin katalogjet teknike te mallrave objekt kontrate.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është ne perputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 6/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi nepermejt katalogut te produkteve behet e mundur verifikimi i specifikimeve teknike te domosdoshme per te realizuar me sukses kontraten.

2.2.6 Ofertuesi duhet të paraqese dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një tablele (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës. Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr. I produktit	Emertimi i produktit	Emri I kompanise prodhuese	Emri I katalogut	KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	Shenim sqarues
-----------------	----------------------	----------------------------	------------------	--	----------------

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është ne perputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 6/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi nepermejt ofertes teknike behet e mundur behet e mundur verifikimi i specifikimeve teknike te domosdoshme per te realizuar me sukses kontraten.

2.2.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqese certifikatat ISO 9001:2015 “Sistemet e menaxhimit te cilesise” te vlefshme, per mallrat objekt prokurimi te leshuar nga kompani te cilat njihen nga institucionet zyrtare Shqiptare dhe qe jane te akredituara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është

gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi kjo certifikate ka te bej me cilesin e produktit qe furnizohet, duke garantuar Autoritetin kontraktor per mallin qe furnizohet.

2.2.8 Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate ISO 14001:2015 , “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekujvalente, per mallrat objekt prokurimi te leshuar nga kompani te cilat njihen nga institucionet zyrtare Shqipetare dhe qe jane te akredituara

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter eshte gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi kjo certifikate ka te bej me sigurine qe ofrohet gjate kryrjes se procesit te instalimit te pajisjeve. Per shendetin dhe jeten e punonjesve qe do te marrin pjese ne kete proces, pasi pjesa me e madhe e mallrave te qe do te furnizohen jane F.V dhe eshte nje proces i veshtire pasi kemi te bejme me pajisje elektrike, mekanike dhe qe do te instalohen ne puseta.

2.2.9 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesin flete garanci me afat 12 muaj per mallrat objekt te ketij tenderimi, duke filluar nga data e furnizimi/montimit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. eshte gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi garancia e mallrave jep siguri per furnizime cilesore dhe e ben operatorin ekonomik fitues me te pergjegjshem per produktet qe oferton.

2.2.10 Operatori ekonomike duhet te disponoje te pakten nje mjet transporti, per transportimin e mallrave.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor); b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (lejeqarkullimi); c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS); ç) siguracioni (polica e sigurimit) I vlefshëm I mjetit; Kur janë me qera, duhet të paraqitet: a) kontrata noteriale e qerasë; b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (lejeqarkullimi); c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS); ç) siguracioni (polica e sigurimit) I vlefshëm I mjetit dhe foto te mjetit .

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. eshte gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi mjeti i transportit nevojitet per transportin e mallrave objekt prokurimi.

Njesia e Prokurimit